

DEKRET
Nr.13213, datë 14.9.2021

PËR EMËRIMIN E KËSHILLIT TË MINISTRAVE

Në mbështetje të neneve 93, 95 pika 1, 96, 97, 98, dhe 99 të Kushtetutës, pas zhvillimit të zgjedhjeve të përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë të datës 25.4.2021, rezultati përfundimtar i të cilave është shpallur nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve përmes vendimit nr. 21, datë 13.7.2021, të Komisionit Rregullator, me propozim të Kryeministrit¹ nr. 4281 prot., datë 11.9.2021, si dhe pas administrimit të informacionit prej organeve ligjzbatuese për verifikimin e kandidatëve të propozuar si anëtarë të Këshillit të Ministrave,

DEKRETOJ:

Neni 1

Emërimin e Këshillit të Ministrave me këtë përbërje:

- 1) Zoti Edi Rama- Kryeministër;
- 2) Zoti Arben Ahmetaj - Zëvendëskryeministër dhe ministër i Shtetit për Rindërtimin dhe Programin e Reformave;
- 3) Zonja Olta Xhaçka - Ministër për Evropën dhe Punët e Jashtme;
- 4) Zoti Niko Peleshi - Ministër i Mbrojtjes;
- 5) Zoti Bledar Çuçi - Ministër i Brendshëm;
- 6) Zonja Delina Ibrahimaj- Ministër i Financave dhe Ekonomisë;
- 7) Zonja Belinda Balluku - Ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë;
- 8) Zonja Evis Kushi - Ministër i Arsimit dhe Sportit;
- 9) Zoti Ulsi Manja - Ministër i Drejtësisë;
- 10) Zonja Elva Margariti - Ministër i Kulturës;
- 11) Zonja Frida Krifca - Ministër i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural;
- 12) Zonja Ogerta Manastirliu - Ministër i Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale;
- 13) Zonja Mirela Kumbaro Furxhi - Ministër i Turizmit dhe Mjedisit;
- 14) Zonja Elisa Spiropali - Ministër i Shtetit për Marrëdhëniet me Parlamentin;
- 15) Zonja Edona Bilali - Ministër i Shtetit për Mbrojtjen e Sipërmarrjes;
- 16) Zonja Bora Muzhaqi - Ministër i Shtetit për Rininë dhe Fëmijët;
- 17) Zonja Milva Ekonomi - Ministër i Shtetit për Standardet e Shërbimeve.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Ilir Meta

¹ Zoti Edi Rama është emëruar Kryeministër në fillim të legjislaturës së X-të, me Dekretin e Presidentit të Republikës nr.1 321 0, datë 10.9.2021.

